



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Instituti: Demokraci për Zhvillim
| Seria: Analizë e Politikave dhe Hulumtim | Nr. 5 | Prishtinë, 2017 |

ANALIZË E SHKURTËR E POLITIKAVE

Investimet e huaja direkte dhe
eksportet: Kosova dhe Ballkani
Perëndimor



Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

ANALIZË E SHKURTËR E POLITIKAVE

Investimet e huaja direkte dhe
eksportet: Kosova dhe Ballkani
Perëndimor

Prishtina, November 2017

E drejta e autorit © 2017. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të fragmenteve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe kontrollimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në sistem ku mund të përdoret sërish, apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet, incizohet apo tjera, pa lejen paraprake të D4D-së.

Punimi i përgatitur nga: Agon Nixha

“Ky botim (ose publikim) është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”

Contents

Hyrje	6
Pasqyrë e përgjithshme e IHD-ve në Kosovë.....	8
<i>Trendet e IHD-ve sipas vendit të burimit.....</i>	<i>8</i>
<i>Trendet e IHD-ve sipas sektorëve.....</i>	<i>10</i>
Pasqyrë e përgjithshme e eksporteve në Kosovë	12
<i>Trendet e eksporteve sipas destinacionit</i>	<i>13</i>
<i>Trendet e eksporteve sipas sektorëve</i>	<i>14</i>
<i>Eksporti i shërbimeve</i>	<i>15</i>
IHD-të në Ballkanin Perëndimor	16
<i>Vëllimi i fluksit të IHD-ve në Ballkanin Perëndimor.....</i>	<i>16</i>
<i>Fluksi i IHD-ve në relacion me PBB dhe popullsinë</i>	<i>18</i>
Eksportet në Ballkanin Perëndimor	22
<i>Vëllimi i eksporteve në Ballkanin</i>	<i>22</i>
<i>Eksportet në raport me PBB dhe popullsinë</i>	<i>23</i>
Konkluzione dhe rekomandime.....	30
List of Publications	Error! Bookmark not defined.
Endnote.....	40

Shkurtesat

CEFTA - Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore

EUR - Euro

IHD - Investimet e huaja direkte

PBB - Produkti i Brendshëm Bruto

KAP - Fabrika e Aluminit në Podgoricë

KIESA - Agjencia Kosovare e Investimeve dhe Mbështetjes së Ndërmarrjeve

IOM - Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

ZPE - Zonat e Posaçme Ekonomike

TAP - Projekti Transatlantik

UNDP - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

USD –Dollari amerikan

BP - Ballkani Perëndimor

Hyrje

Ka shumë e punë empirike që ka për qëllim shqyrtimin e përcaktuesve të rritjes së qëndrueshme në ekonomitë në zhvillim gjatë viteve të fundit. Në mesin e grupit të madh të aspekteve politike, ligjore dhe sociale, zakonisht pranohet gjerësisht se investimet e huaja direkte (IHD) dhe eksportet përbëjnë dy faktorë të rëndësishëm që kontribuojnë në rritjen ekonomike të ekonomitë në zhvillim.

Efektet pozitive të fluksit të IHD-ve ndodhin në shumë mënyra. Me kusht që në vendet në zhvillim normat e kursimit janë relativisht të ulëta, IHD ndihmon në rritjen e investimeve, duke çuar, ndër të tjera, në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në gjenerimin e të ardhurave tatimore. Përveç kësaj, IHD ofron qasje në teknologji të përparuar që luan rol pozitiv në elementin e rritjes së gjithmbarshme të produktivitetit dhe në elementin e të ardhurave. Me investime nga firmat e huaja në ekonominë e pranuesit, teknologjia moderne dhe ekspertiza (njohuritë) përhapen me anë të lidhjeve dhe shkëmbimeve të ndryshme formale dhe joformale, duke ndihmuar kështu për të përmirësuar produktivitetin e tyre.¹ Për më tepër, konkurrenca ndërkombëtare që rezulton nga fluksi i IHD-ve lejon që ekonomia pritëse t'i rrisë eksportet dhe të përmirësojë bilancin e pagesave, dhe, në shumë raste, të bëjë lehtësimin e shtrëngimeve financiare ndërkombëtare ndaj rritjes ekonomike.² Në fund, IHD, nëpërmjet të gjitha kontributeve të saj direkte dhe indirekte, mund të shërbejë si shtytës i kryesor në ristrukturimin e ndërmarrjeve, si dhe në ristrukturimin e përgjithshëm ekonomik.³

Rritja e shtyrë nga eksporti, gjithashtu, ka efekte të shumëfishta pozitive në prodhimin e vendit. Tregjet e eksportit mundësojnë rritje të qëndrueshme, për shkak se nuk përfshijnë asnjë kufizim sa i përket madhësisë së kërkesës, duke lënë të kuptohet se ka pothuajse kërkesë të

pakufizuar.⁴ Rritja e eksportit e rrit faktorin e produktivitetit si pasojë e fitimeve të nxjerra nga rritja e shkallës së kthimit.⁵ Përveç kësaj, eksportet mund të ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit dhe në përgatitjen e ndërmarrësve. Ndërveprimi me tregjet e huaja, të mundësuar nga eksportet, kontribuon në importimin e teknologjive të avancuara dhe të ekspertizës sa i përket prodhimit, duke promovuar përhapje ndër-kufitare të njohurive.⁶ Për më tepër, rritja e eksporteve lehtëson pengesat në shkëmbimin valutor, gjë që rezulton në importin e teknologjisë/të imputeve të ndërmjetme që kërkojnë sasi të madhe të kapitalit investues. Vlen të përmendet, gjithashtu, se rritja e eksporteve mund të krijojë eksternalitete pozitive në sektorët jo të eksportit të vendit,⁷ përmes ofrimit të stimujve për avancimet teknologjike, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, si dhe menaxhimin më efikas.⁸ Kjo kryesisht i atribuohet qasjes direkte të firmave të eksportit në njohuritë e huaja. Në përgjithësi, vendet në zhvillim me pjesën më të madhe të eksporteve në ekonominë i kanë tejkaluar vendet me më pak eksporte për shkak të efekteve të pozitive të lartcekura.

Për më tepër, ekziston edhe një varg i gjatë i literaturës që sugjeron se eksportet dhe IHD-të mund të ketë një marrëdhënie pozitive dykahëshe, që më pas përkthehet në rritje ekonomike.⁹ Nga njëra anë, vëllimi më i madh i prurjeve neto të IHD-ve i rrit kapacitetet eksportit të vendit pritës; ndërsa, në anën tjetër, qasja në tregjet më të mëdha tërheq më shumë prurje neto të IHD-ve. Me pak fjalë, promovimi i rritjes së IHD-ve dhe i eksporteve është thelbësor për arritjen e rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Në përgjithësi, Ballkani Perëndimor (BP) nuk ka performuar shumë mirë në këto dy aspekte. Kosovë, në veçanti, ka ngecur prapa, duke zënë vendet e poshtme në të gjithë treguesit e IHD-ve dhe ata të eksportit. Duke e thënë këtë, ky studim mbi politikat ka për qëllim që të hedhë dritë mbi

modelet e IHD-ve dhe të eksporteve në Kosovë në veçanti dhe në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi.

Pjesa tjetër e kësaj analize të politikave është i organizuar si më poshtë. Në Pjesën 2 jepet një pasqyrë të përgjithshme të IHD-ve në Kosovë, duke u fokusuar në trendet e fundit, të kategorizuara sipas vendit të burimit dhe sipas sektorëve. Në Pjesën 3 jepet një pasqyrë të përgjithshme e eksporteve në Kosovë, duke u përqendruar edhe në trendet më të fundit në bazë të destinacioneve dhe të sektorëve kryesorë. Në Pjesët 4 dhe 5 krahasohet performanca e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor përkitazi me investimet e huaja direkte, respektivisht eksportet. Në Pjesën 6 konkludohet dhe nxjerren rekomandime që i dedikohen posaçërisht Kosovës.

Pasqyrë e përgjithshme e IHD-ve në Kosovë

Në vitin 2016, IHD-të në Kosovë kanë shënuar rënie prej rreth 30 përqind në krahasim me vitin paraprak, nga 308.8 milionë euro në 215.9 milionë euro. Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbëjnë pjesën më të madhe e IHD-ve, kanë shënuar rënie prej rreth 26 përqind, nga 243.7 milionë euro në 179.0 milionë euro. Përveç kësaj, instrumentet e borxhit kanë rënë me 54 përqind, nga 80.7 milionë euro në vitin 2015 në 36.9 milionë euro në vitin 2016. Rënia ka qenë e pranishme gati në të gjithë sektorët. Një rënie më e dukshme është shënuar në sektorin e pasurive të patundshme dhe sektorin e shërbimeve financiare, rreth 39 përqind, përkatësisht 70 përqind, krahasuar me vitin e kaluar.¹⁰ Kjo mund të sugjerojë se tregu për këta dy sektorë është duke u ngopur.

Trendet e IHD-ve sipas vendit të burimit

Tabela 1 paraqet trendet IHD-ve në një kontekst më të gjerë kohor (duke përfshirë pesë vitet e fundit), duke u fokusuar në vendet burimore më të larta në bazë të vlerës së

investimeve. Kosova ka arritur të tërheqë afër 1.2 miliardë euro të IHD-ve në pesë vitet e fundit. Për këtë periudhë, Turqia e kryeson listën e vendeve burimore me 274 milionë euro (23 përqind të totalit të IHD-ve), e pasuar nga Zvicra me 258.4 milionë euro (22 përqind), dhe Gjermania me 171.6 milionë euro (14 përqind). Vëllimi i lartë i IHD-ve nga Turqia pjesërisht i atribuohet privatizimeve dhe investimeve në asetet e privatizuara që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe, e veçanërisht privatizimi i distribucionit dhe i furnizimit me energji elektrike, si dhe investimet në terminalin e ri në aeroport. Nga ana tjetër, Zvicra dhe Gjermania kanë qenë gjithmonë burim i madh i IHD-ve për shkak të përqendrimit të diasporës kosovare në këto dy vende.

Tabela 1: Fluksi i IHD-ve sipas vendit të burimit (në milionë euro)

	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL	% e totalit të IHD-ve
Fluksi i IHD-ve(milionë €)	229	280	151	309	216	1,185.20	-
Turqia	65.6	88.6	20	55.4	44.4	274	23%
Zvicra	43.8	41.7	38.2	72.9	61.8	258.4	22%
Gjermania	49.5	21.7	29.4	45.3	25.7	171.6	14%
Shqipëria	4.7	19.3	20.4	40.1	28.6	113.1	10%
SHBA	10.8	12.7	14.7	25	22.6	85.8	7%
Austria	0.38	10.7	30.3	33.5	9.95	84.8	7%
Bullgaria	8.1	5.56	14.5	1.56	0.43	30.2	3%
Mbretëria e Bashkuar	14.3	10.7	-39	26.6	13.6	25.8	2%
Italia	4.38	8.73	3.31	5.67	1.91	24	2%
Norvegjia	2.86	4.7	5.95	2.88	3.44	19.8	2%

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës 2017 **Error! Bookmark not defined.**

Trendet e IHD-ve sipas sektorëve

Shpërndarja sektoriale është me rëndësi shumë të madhe kur bëhet fjalë për vlerësimin e efekteve afatgjata të IHD-ve, veçanërisht efektet e tyre për rritjen e eksportit. Tabela 2 e tregon shpërndarjen sektoriale e IHD-ve në Kosovë gjatë pesë viteve të fundit.

Për pesë vitet e fundit, pasuritë e patundshme rezultojnë të jenë sektori kryesor për shumicën e flukseve të IHD-ve, me një vlerë të përgjithshme prej 751.1 milionë euro, duke përfaqësuar rreth 63 përqind. Vëllimi i lartë të IHD-ve në sektorin e pasurive të patundshme kryesisht i atribuohet diasporës së Kosovës, e cila në mënyrë që të mbajë një lloj lidhje me vendin e vet të origjinës, investojnë shuma të mëdha parash në ndërtimin e shtëpive të reja dhe në blerjen e apartamenteve. Këto prona zakonisht përdoren gjatë festave të verës ose dimrit kur ata vijnë për t'i vizituar të afërmit e tyre, por mbeten bosh shumicën e kohës gjatë vitit. Sipas një studimi të kryer nga IOM-i dhe UNDP-ja (2013), rreth 60 përqind të investimeve të diasporës kosovare kanalizohen drejt këtij sektori.¹¹ Në përgjithësi, këto lloj investimesh, për shkak të efekt relativisht të ulët shumëfishues, nuk prodhojnë përfitime të konsiderueshme për ekonominë.

Dy sektorët e mëposhtëm, që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme në totalin e IHD-ve gjatë kësaj periudhe, janë sektori financiar dhe sektori i ndërtimit me 152 milionë euro (13 përqind), përkatësisht 103 milionë euro (9 përqind). Kërkesa për shërbime financiare nga individët, bizneset dhe sektorin publik i ka stimuluar bankat e huaja për të investuar në Kosovë. Rreth 90 përqind e aseteve në sektorin financiar në Kosovë janë në pronësi të bankave të huaja.¹² Sektori i ndërtimit, në anën tjetër, është një nga sektorët kyç që kontribuon për IHD-të. Investimet e mëdha në autostrada që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit

përbëjnë një pjesë të madhe të IHD-ve në këtë sektor.

Sektori i energjisë elektrike dhe i furnizimit me ujë; transporti, ruajtja, dhe sektori i komunikimit; dhe sektori me shumicë dhe pakicë, përbëjnë një pjesë më të vogël, 79.7 milionë euro (7 përqind), 58.8 milionë euro (5 përqind) dhe 57.1 milionë euro (5 përqind), respektivisht. Sektori i energjisë elektrike dhe i furnizimit me ujë kanë përjetuar një trend në rënie gjatë viteve dhe në përgjithësi nuk tërheqin flukse të mëdha të IHD-ve. Sasia më e madhe e fluksit të IHD-ve në këtë sektor përkon me periudhën kur u privatizuan distribucioni dhe furnizimi me energji elektrike. IHD-të në transport, ruajtja, dhe komunikim po ashtu kanë shënuar një trend në rënie, pjesërisht për shkak të dalja së dividendëve në nën-sektorin e telekomunikacionit. Në fund, IHD-të në sektorin me shumicë dhe pakicë, megjithëse më të vogla në total, ka qenë të qëndrueshme gjatë viteve. Ky sektor në të vërtetë është pakrahasimisht kontribuuesi më i madh në sektorin privat sipas xhiros kumulative dhe numrit të të punësuarve (rreth 3.9 miliardë euro dhe 45 të punësuar, përkatësisht). Keni parasysh re se shumica e investimeve të huaja direkte për sektor është më e madhe se vlera totale e investimeve të huaja direkte, për faktin se sektorët me vlera të përgjithshme negative (si sektori i minierave) nuk janë marrë parasysh në tabelën më poshtë.

Tabela 2: IHD-të sipas shpërndarjes sektoriale (në milionë euro)

	2012	2013	2014	2015	2016	TOTALI	% e totalit IHD-ve
Totali i IHD-ve (milionë €)	229	280	151	309	216	1,185.20	-
Patundshmëritë, qiradhënia dhe veprimtaritë afariste	116	136	142	190	168	751.1	63%
Ndërmjetësit financiarë	22.4	4.4	41.9	64.3	19	152	13%
Ndërtimi	31.1	17.3	-20	46.3	28.2	103	9%
Furnizimi me energjia elektrike, gazë dhe ujë	2.2	48.8	13.4	11.9	3.4	79.7	7%
Transporti, ruajtja dhe komunikimi	32.4	51	-9.1	-6.1	-9.4	58.8	5%
Shitja me shumicë, tregtia me pakicë, riparimi i veturave me motor	9.3	14.6	8.4	12	12.8	57.1	5%
Prodhimi	27.4	11.5	-34	20.7	5.3	31	3%

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës 2017

Pasqyrë e përgjithshme e eksporteve në Kosovë

Kosova karakterizohet nga eksporte shumë të ulëta. Në vitin 2016, eksportet e mallrave kanë shënuar një rënie të lehtë prej rreth 5 përqind krahasuar me vitin e mëparshëm, nga 325.3 milionë euro në 309.7 milionë euro. Kjo rënie kryesisht është nxitur nga rënia e eksporteve në metalet bazë, që përbëjnë pjesën më të madhe të eksporteve në Kosovë.¹³ Rënia e eksporteve e metaleve bazë ka ndodhur si rezultat i prodhimit më të ulët (për shkak të kërkesës më të ulët) për nikel dhe rënies së çmimeve të metaleve në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2016. Dy sektorë të tjerë që kanë luajtur rol në uljen e përgjithshme kanë qenë tekstili dhe

makineritë/pajisjet elektrike.

Trendet e eksporteve sipas destinacionit

Anëtarët e CEFTA-s dhe të BE-së kanë qenë destinacionet kryesore të eksporteve të Kosovës (të mallrave) gjatë pesë viteve të fundit. Gjatë këtyre viteve, eksportet drejt anëtarëve të CEFTA-s arritën në shumën prej 599.9 milionë euro ose 39 përqind të totalit. Pak më pak kanë qenë eksportet drejt vendeve anëtare të BE-së, duke arritur në 502.3 milionë euro ose 33 përqind të totalit. Dy arsyt kryesore që shpjegojnë dominimin e këtyre destinacioneve kanë të bëjnë me afërsinë gjeografike dhe marrëveshjet e tregtisë (marrëveshja e tregtisë së lirë me vendet e CEFTA-s; të Preferencës Autonome të Tregtisë dhe tani Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me BE-në). Nga 10 destinacionet e eksportit për pesë vitet e fundit, Italia rezulton të jetë destinacioni i parë me 220.7 milionë euro (14 përqind), edhe pse me një rënie të mprehtë që nga viti 2012 nga 71.4 milionë euro në vetëm 5.7 milionë euro në vitin 2016. Më pas vjen Shqipëria me 210.3 milionë euro (14 përqind). Një rritje e dukshme gjatë gjithë këtyre viteve është regjistruar me eksportet në Serbi, nga 15 milionë euro në vitin 2012 në 41.3 milionë euro në vitin 2016. Ky vend tashmë është bërë destinacioni i dytë sa u përket eksporteve të Kosovës. Kjo është rezultat i marrëveshjeve të reja të arritura ndërmjet këtyre dy vendeve, që kanë ndihmuar në zbutjen e pengesave jo-tarifore në veçanti. Për më shumë informata të detajuara, ju lutemi shihni Tabelën 3.

Tabela 3: Eksportet e Kosovës sipas destinacionit në pesë vitet e fundit

Eksportet (në milion €)	2012	2013	2014	2015	2016	Totali	% e totalit të eksporteve
Totali	276.1	293.8	324.5	325.3	309.7	1529.5	-
CEFTA	100.3	104.5	127.1	123.7	144.3	599.9	39%
BE 28	109.8	118.4	98.1	106.1	70	502.3	33%

Italia	71.4	74.4	49.7	19.6	5.7	220.7	14%
Shqipëria	40.2	43.8	44	40.3	42.1	210.3	14%
Maqedonia	26.4	26.1	36	33.4	38.6	160.4	10%
India	22.9	29	27.4	47	9.4	135.7	9%
Serbia	15	14.5	27.3	32.3	41.3	130.3	9%
Mali i Zi	16.8	17.3	16.1	12.1	13.9	76.2	5%
Gjermania	15	11	11.3	11.7	13.8	62.9	4%
Zvicra	15.1	7.2	10	11.7	16.8	60.8	4%
Turqia	11.4	7.4	10.4	9.2	7.6	46	3%
Austria	4.4	6.3	6.4	12.3	6.7	36.2	2%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës 2017 **Error! Bookmark not defined.**

Trendet e eksporteve sipas sektorëve

Tabela 4 tregon eksportet e mallrave të Kosovës sipas sektorit gjatë pesë viteve të fundit. Këta sektorë në të vërtetë përbëjnë mesatarisht rreth 96 përqind të të gjitha eksporteve (të mallrave) për këtë periudhë. Për të gjitha këto vite, metalet bazë kanë prirë me të madhe deri tani me një vlerë të përgjithshme prej 726 milionë euro ose 45 përqind. Kosova ka një traditë të gjatë të përpunimit të metaleve. Eksportet më të mëdha të produkteve të metalit ndodhin nga ish-ndërmarrjet shoqërore, që tani janë privatizuar dhe janë ndarë në ndërmarrje më të vogla me një stil modern të prodhimit. Nga të gjitha produktet bazë të metaleve që eksportohen, mbizotëron ferronikeli i përpunuar, i pasuar nga hekuri dhe prodhimet e çelikut. Prodhimet minerale janë prodhimet e dyta më të eksportuar me 235 milionë euro ose 15 përqind. Trepça, kompleksi i madh industrial, është përgjegjës për shumicën e eksporteve. Pjesëmarrja e sektorëve të tjerë është në shifra një shifrore. Vlen të përmendet se rritjet shumë të larta janë vërejtur në prodhimet e plastikës dhe të gomës dhe ato kimike; eksportet e këtyre prodhimeve në vitin 2016 (gati) u

dyfishuan krahasuar me vitin 2012. Për informata më të detajuara në lidhje me sektorët e tjerë, ju lutem shih tabelën më poshtë.

Tabela 4: Eksporti i Kosovës në mallra sipas sektorëve në pesë vitet e fundit

Eksporti sipas sektorëve (në milion EUR)	2012	2013	2014	2015	2016	Total	% e totalit të eksporteve
Totali	276	294	325	325	310	1530	-
Metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë	146	144	167	158	111	726	47%
Prodhimet minerare	36.5	48.4	44.7	41.6	63.9	235	15%
Prodhimet e përgatitura ushqimore, pijet dhe duhani	16.1	19.3	20.5	25.4	27.6	109	7%
Artikujt e plastikës, gomës dhe të tjerë si këta	14	18.2	16.3	23.5	28.9	101	7%
Prodhimet e perimeve	14.4	15.4	18.5	15.5	16.8	80.7	5%
Pajisjet e makinerive dhe materialet elektrike	16.7	12.6	13.4	12.3	9.2	64.2	4%
Tekstilet dhe artikujt e tekstilit	11.4	12.8	14.7	12	8.8	59.6	4%
Lëkura dhe artikujt e lëkurës	10.4	11.7	11.4	10.8	11.2	55.4	4%
Artikujt të përzier të përpunuar	2.5	2.6	3.6	4.6	9.8	23.1	2%
Prodhimet e industrisë kimike	2.5	1.7	2.6	2.9	4.7	14.4	1%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës 2017 **Error! Bookmark not defined.**

Eksporti i shërbimeve

Sa i përket eksportit të shërbimeve, Kosova ka performuar relativisht mirë. Sipas MTI-së, eksportet e shërbimeve në vitin 2016 arritën në 1.038 miliardë euro, duke përfaqësuar rreth 77 përqind të totalit të eksporteve (si në mallra dhe

shërbime) të atij viti. Ka pasur një rritje prej rreth 17 përqind krahasuar me vitin 2015 (887 milionë euro).

Në sektorët kryesorë që marrin pjesë në eksportin e shërbimeve hyjnë: udhëtimet (turizmi) me 809 milionë euro, i pasuar nga biznesi dhe shërbimet profesionale me 63 milionë euro; TIK me 48.5 milionë euro; shërbimet e ndërtimit me 13 milionë euro; dhe shërbimet e Qeverisë me 35.5 milionë euro.¹⁴

IHD-të në Ballkanin Perëndimor¹

Vëllimi i fluksit të IHD-ve në Ballkanin Perëndimor


Gjatë pesë viteve të fundit, vëllimi i përgjithshëm i fluksit të IHD-ve në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) arriti në 22.6 miliardë dollarë (rreth 15 përqind të IHD-ve në Evropën Qendrore dhe vendet baltike), duke arritur kulmin e saj në vitin 2015 me 4.9 miliardë dollar amerikanë. Shpërndarja e flukseve të IHD-ve në radhët e vendeve të BP-së ishte e pabarabartë (shih Figurën 1). Serbia ka tërhequr deri tani shumta më e madhe të fluksit të IHD-ve gjatë këtyre viteve, duke arritur maksimumin e saj në dy vitet e fundit (2.3 miliardë dollar amerikanë në vitin 2015 dhe 2.2 miliardë dollar amerikanë në 2016).¹⁵ Ekonomia relativisht më e madhe për nga madhësia së bashku me numrin e saj më të madh të popullsisë (rreth 7 milion) pjesërisht mund t'i shpjegojë shumat konsiderueshëm më të larta të flukseve të IHD-ve në këtë vend. Perspektiva e BE-së, stimuj të favorshëm, zonat industriale e të ngjashme janë edhe disa faktorë të tjerë që kanë luajtur një rol në dominimin e Serbisë.

Shqipëria vjen e dyta, duke tërhequr shumta relativisht konstante të flukseve të IHD-ve përgjatë viteve (mesatarisht

¹ Për të shmangur ndonjë gabim eventual në konvertim, të gjitha vlerat në analizën ndërmjet vendeve të BP janë mbajtur në formën origjinale - në USD (dollarë amerikanë), siç parashihet nga Banka Botërore.

rreth 1 miliardë dollar amerikanë). Pjesërisht kjo është falë projekteve energjetike që kanë ndodhur në vend gjatë viteve të fundit, e veçanërisht projekti TAP.¹⁶ Vendete tjera të Ballkanit Perëndimor- Maqedonia, Mali i Zi, Kosova dhe Bosnja e Hercegovina - kanë arritur që të tërheqin shuma më të ulëta të flukseve të IHD-ve gjatë gjithë kësaj periudhe. Vlen të përmendet se në mesin e këtyre vendeve, IHD-tënga brenda në Maqedoni ka shënuar një trend të rritjes së mprehtë, ndërsa në Mal të Zi ka ndodhur e kundërta. Në këtë të parën, vëllimi i flukseve të IHD-ve në vitin 2016 ishte rritur me rreth 70 përqind krahasuar me vitin 2012; ndërsa në këtë të fundit, ulja e regjistruar ka qenë rreth 63 përqind. Trendi pozitiv në Maqedoni mund të shpjegohet me lulëzimin e parqeve industriale që ofrojnë stimuj shumë tërheqës për investitorët ndërkombëtarë.¹⁷ Nga ana tjetër, trendi negativ në Mal të Zi është kryesisht për shkak të rrjedhjes të dividendëve nga telekomi.¹⁸

Figura 1: Flukset e IHD-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë pesë viteve të fundit (në milionë USD)




Burimi: Banka Botërore 2017

Fluksi i IHD-ve në relacion me PBB dhe popullsinë

Në mënyrë që flukset e IHD-ve të bëhen më të krahasueshme në të gjithë vendet e BP (kontrollimi i dallimeve në madhësi), ky dokument, përmes Figurës 1 dhe Figurës 2, hedh dritë mbi treguesit për IHD-të dhe PBB dhe IHD-të për kokë banori për pesë vitet e fundit. Në të dy këta tregues, Mali i Zi (përveç në vitin 2016) kryeson në listën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo mund të jetë, deri në një farë mase, mashtruese duke pasur parasysh numrin e vogël të popullsisë (vetëm 0.6 milionë banorë)¹⁹ dhe PBB relativisht i ulët (4.2 miliardë USD).²⁰ Pavarësisht nga kjo, ia vlen të përmendet se Malin e Zi ka zhvilluar një sistem ekonomik të fokusuar në biznes, tërheqës për IHD-të.

Figura 2: Pjesa e IHD-ve në PBB e vendeve të Ballkanit Perëndimor gjatë pesë viteve të fundit (në përqindje)



Burimi: Banka Botërore 2017²¹

Shqipëria renditet e dyta sa i përket IHD-ve në PBB dhe të IHD-ve për kokë banori, me një mesatare prej 8.8 përqind


dhe 374.1 USD, respektivisht. Siç u tregua më parë, kjo performancë e mirë e Shqipërisë është nxitur kryesisht nga projektet e mëdha energjetike, veçanërisht Gazsjellësi Trans-Adriatik dhe projektit hidroenergjetik i Devollit.¹⁸ Reformat strukturore të kohëve të fundit (sidomos në energji dhe në sektorin financiar), forcimi i sistemit gjyqësor, si dhe njohja nga BE-ja si një vend kandidat zyrtar në vitin 2014, mund të jenë disa nga faktorët që kanë pasur një ndikim në flukset e IHD-ve.

Në krahasim me treguesin e parë (totali i flukseve të IHD-ve), këta dy tregues disi e zbehin suksesin e Serbisë sa i përket investimeve të huaja direkte. Pavarësisht kësaj, Serbia ende është në mesin e tre vendeve kryesore të Ballkanit Perëndimor (mesatarja me IHD-të në PBB në 4.9 përqind, mesatarja me IHD për kokë banori në 277.9 USD). Çka është më e rëndësishmja, ka shënuar një trend pozitiv gjatë viteve në të dy treguesit. Kjo pjesërisht ka ndodhur për shkak se Serbia ka intensifikuar përpjekjet e saj për të gjetur më shumë IHD, veçanërisht në sektorin e prodhimit. Investimi i Fiat-Chrysler në fabrikën e prodhimit të veturave në vitin 2012 është një shembull se ekziston një prirje e madhe e të huajve për të investuar në këtë sektor. Vlen të përmendet se Serbia e ka rrjetin më të madh të zonave ekonomike të veçanta (ZVE) –gjithsej 14, të cilat në mënyrë të konsiderueshme kontribuojë në rritjen e sektorit të prodhimit. Në të vërtetë, ndërmarrjet aktive në ZVE në Serbi kanë gjeneruar më shumë se 22.000 vende pune, kanë kontribuar me 15 përqind të të gjitha eksporteve, dhe llogaritet në rreth 80 përqind të totalit të IHD-ve në prodhim gjatë pesë viteve të fundit.¹⁷

Përveç gamës së gjerë të stimuljeve të përgjithshëm fiskal, Serbia, në kushte të caktuara, ofron stimuj të konsiderueshëm që ndërlidhen me punën në formën e subvencioneve të punësimit dhe të lirimit nga tatimet në punë dhe në kontributet pensionale, veçanërisht për

ndërmarrjet e vendosur në ZVE.¹⁷ Këta stimuj së bashku me marrëveshjet preferenciale të tregtisë (BE, Rusi dhe Turqi), perspektivat e BE-së, tregu i madh i brendshëm, afërsia gjeografike, procedurat e efektshme e të ngjashme kanë pasur efekt në tërheqjen e IHD-ve në këtë vend.

Figura 3: IHD-të për kokë banori në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë pesë viteve të fundit (në USD)



Burimi: Përlllogaritjet e autorit bazuar në Bankën Botërore (2017) IHD

Maqedonia renditet më pas me një mesatare të IHD-ve në PBB prej 3.2 përqind, duke arritur maksimumin e vet në vitin 2016 (5.3 përqind). Mesatarja e IHD-ve për kokë banori ka qenë 160.8 USD, duke arritur kulmin e saj në vitin 2016 (275.4 milion euro). Maqedonia gjithashtu ka një rrjet të gjerë të ZVE funksionale dhe ofron për gamën më të gjerë të stimujve tatimorë dhe jo-tatimore ndaj investitorëve, duke përfshirë, jo vetëm: inkurajimin e subvencioneve, stimujt e lidhur me punën, kushte të favorshme të kreditimit, garancitë shtetërore, dhe stimujt në taksa.¹⁷ Këta stimuj kanë luajtur një rol pozitiv në tërheqjen e investimeve prodhuese në veçanti. Perspektivat e BE-së,

marrëveshjet tregtare, dhe procedurat e efektshme tatimore dhe doganore –për t'i përmendur disa - kanë pasur ndikim edhe në investimet e huaja direkte. Tensionet politike të pranishme gjatë viteve të fundit, nga ana tjetër, i kanë penguar investitorët potencialë. Pa këto, mesataret e këtyre treguesve mund të kishin qenë më të larta.¹⁸

Kosova është ndër vendet e Ballkanit Perëndimor që zë vendet e fundit. Gjatë pesë viteve të fundit, mesatarja e IHD-ve në PBB ka qenë 4.3 përqind, ndërsa IHD-të për kokë banori ishin 159.6 USD. Kulminacioni gjatë kësaj periudhe ishte arritur në vitin 2013, sipas Figurës 2 dhe Figurës 3. Kjo lidhej kryesisht me investimet në terminalin e ri të aeroportit nga konsorciumi Limak-Aeroport de Lyon. Rënia e fluksit të IHD-ve në vitin 2014 dhe 2016, edhe pse jo shumë e rëndësishme, mund të jetë i lidhur me vonesat në krijimin e qeverisë dhe trazirat e fundit në parlament për shkak të demarkacionit me Malin e Zi; rënia në vitin 2016 është rezultat i rënies së kërkesës së diasporës për investime direkte. Në parim, jo stabiliteti politik mund t'i dekurajojë seriozisht investitorët e huaj për të investuar kapitalin e tyre në vendin pritës. Sa i përket përbërjes së IHD-ve, siç është treguar, sektori i pasurive të patundshme dhe sektori i shërbimeve financiare përbëjnë pjesën më të madhe të fluksit të IHD-ve. Për dallim nga vendete tjera të Ballkanit Perëndimor që zënë vendet më të larta, fluksi i IHD-ve në sektorin e prodhimit është shumë i ulët në Kosovë.

Megjithëse ka pasur disa përmirësime të rëndësishme në racionalizimin e procedurave (lehtësimin e fillimit të një biznesi, regjistrimit të një pronë, e të ngjashme),²² Kosova, përveç tjerash, ka mbetur prapa vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor sa i përket regjimeve të stimujve ndaj investimeve. Taksat e ulëta nuk janë të mjaftueshme duke pasur parasysh se vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, sidomos Serbia dhe Maqedonia, kanë qenë shumë agresive në ofrimin e paketave të ndryshme stimulues, duke

përfshirë ato financiare. Ligji për Investimet Strategjike²³ i miratuar kohëve të fundit në Kosovë, është një përparim për vetë faktin se i dallon investitorët strategjikë nga investitorët e vegjël, megjithatë, ai nuk ofron stimuj financiar apo fiskal. Tregu i vogël për nga madhësia (qasja e kufizuar në vendet e eksportit për shkak të barrierave joutarifore), imazhi i keq i trashëguar, sistemi joefikas gjyqësor, përveç tjerash, mund të jenë disa aspekte që e pengojnë rritjen e IHD-ve në vend.

Bosnja dhe Hercegovina është renditur në fund të vendeve të Ballkani Perëndimor sa u përket me IHD-vetë në pesë vitet e fundit (mesatarisht IHD-të në PBB- 2 përqind dhe IHD-të për kokë banori—99.6 USD). Nga viti 2014, fluksi i IHD-ve gati është përgjysmuar. Ligje të komplikuar të punës dhe të pensioneve, mungesa e një hapësire të vetme ekonomike, dhe mbrojtja joadekuate gjyqësore dhe rregullatore, si dhe paketa konkurruese për investitorët nga fqinjët e saj i kanë penguar frenuar investitorët potencialë.²⁴


Eksportet në Ballkanin Perëndimor

Vëllimi i eksporteve në Ballkanin

Në Figurën 4 paraqitet vlera e eksporteve të mallrave dhe të shërbimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor në pesë vitet e fundit. Vlera totale për këtë periudhë arriti shumën prej 177.2 miliardë USD (4 përqind të totalit të eksporteve të vendeve të Evropës Qendrore dhe të atyre Baltike). Përsëri, ngjashëm me IHD-të, veçanërisht për shkak të madhësisë së saj (popullsisë dhe ekonomisë), Serbia i tejkalon shumë vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor sa u përket eksporteve të mallrave dhe të shërbimeve në këtë periudhë, duke llogaritur rreth 50 përqind të totalit; e pasuar nga Bosnja me 17 përqind, Maqedonia me 14 përqind, dhe Shqipëria me 10 përqind. Mali i Zi dhe Kosova kanë eksportuar më pak krahasuar me vendete tjera të Ballkanit

Perëndimor, e që përbëjnë vetëm 5 përqind dhe 4 përqind të totalit, respektivisht. Keni parasysh se edhe në Malin e Zi, madhësia e popullsisë dhe e ekonomisë janë të rëndësishme. Për ta kompensuar madhësinë e popullsisë dhe atë ekonomike, në pjesën tjetër, si në rastin e IHD-ve, do të krahasohen në mënyrë të detajuar vendete Ballkanit Perëndimor përmes dy treguesve të eksportit, domethënë eksportet në PBB dhe eksportet për kokë banorë.

Figura 4: Vëllimi i eksporteve në vendet e Ballkanit Perëndimor në pesë vitet e fundit (në milionë USD)



Burimi: Banka Botërore 2017²⁵


Eksportet në raport me PBB dhe popullsinë

Në Figurën 5 dhe Figurën 6 paraqiten treguesit e eksportit (eksportin për kokë banori dhe eksportin –në-PBB), në bazë të të cilave do të krahasohen vendet e Ballkanit Perëndimor, duke iu referuar gjithashtu vlerave totale të eksporteve. Të

gjithë këta tregues do të japin një tablo më të plotë të eksporteve.

Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi kanë qenë vendet më të integruara të Ballkanit Perëndimor gjatë pesë viteve të fundit, ku eksportet e mallrave dhe të shërbimeve përbënin rreth 47 përqind, 44 përqind dhe 42 përqind të PBB. Të njëjtat vende prijnë në raport me eksportet për kokë banori, me një ndryshim të vendeve ndërmjet Maqedonisë dhe Malit të Zi. Mesatarisht, eksportet për kokë banori në Mal të Zi kanë arritur në 2,851.3 USD, në Serbi 2,497.7 USD, dhe në Maqedoni 2,375.4 USD.

Figura 5: Pjesëmarrja e eksporteve në PBB e vendeve të Ballkanit Perëndimor gjatë pesë viteve të fundit (në përqindje)




Burimi: Banka Botërore 2017²⁶

Gjatë viteve të fundit, falë reformave të orientuara kah sektori privat, procedurave tatimore dukshëm të thjeshtuara, reformave në administratën publike dhe në

NSH-të, përmirësimin të kadastrës, racionalizimit të lejeve të ndërtimit, konsolidimit fiskal, si dhe stimujve financiarë (subvencionet për investitorët strategjikë), Serbia ka përjetuar një rritje të fortë të bazuar gjerësisht në eksport, veçanërisht të nxitur nga flukset e kohëve të fundit të IHD-ve në prodhim (industria e automobilave, në mënyrë të veçantë). FIAT-i ka qenë eksportuesi më i madh individual me 1.5 miliardë USD,²⁷ që përbën rreth 8 përqind të totalit të eksporteve të tanishme. Eksporti i shërbimeve, i dominuar nga turizmi dhe transporti, ka luajtur rol në eksportet e vendit, duke përbërë mbi 25 përqind të totalit të eksporteve. Për Serbinë, BE-ja ka qenë destinacion më i madh i eksportit, duke llogaritur më shumë se 60 përqind të eksporteve, e pasuar nga CEFTA (mesatarisht, rreth 10 përqind) dhe Rusia (mesatarisht, më pak se 8 përqind).²⁸

Figura 6: Eksportet për kokë banori në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë pesë viteve të fundit (në USD)



Burimi: Përlllogaritjet e autorit bazuar në të dhënat e Bankës Botërore (2017)

Maqedonia u karakterizua gjithashtu nga një rritje e

vazhdueshme e eksporteve në përgjithësi. Kjo, ndër të tjera, u nxit nga tërheqja e IHD-ve në sektorin e prodhimit si rezultat i politikave të favorshme stimuluese. Eksportet e mallrave përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 90 përqind të totalit të eksporteve. Potenciali për eksportet shtesë u pengua nga informaliteti - që nga ana e vet ndikoi në konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve private. Destinacioni kryesor i eksportit ka qenë BE-ja, që përbënte nga 60-70 përqind të totalit të eksporteve gjatë viteve të fundit.²⁷

Vlen të theksohet se gjatë këtyre viteve, si Serbia ashtu edhe Maqedonia e kanë rritur proporcionin e produkteve për të cilat duhen aftësi të larta dhe të mesme, si dhe ato me teknologji intensive përmes pjesëmarrjes në zinxhirët e vlerave evropiane. Kjo u ka ndihmuar këtyre vende në zgjerimin e pjesëmarrjes së eksporteve në BE. Një tendencë e dukshme gjatë viteve të fundit në të dyja vendet është krijimi i ndërmarrjeve dhe përgatitja e punëtorëve të kualifikuar që ofrojnë komunikim, informacion, dhe shërbime kompjuterike për tregjet e eksportit, ndonëse këto mbeten në nivel të ulët.

Mali i Zi, për dallim nga shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor (përveç Kosovës), shumicën e eksporteve të saj e bazon në shërbime, me mbi 80 përqind gjatë pesë viteve të fundit.²⁷ Riviera e Malit të Zi tërheq shumë turistë, duke e bërë këtë sektor kontribuuesin më të madh të eksporteve të vendit. Rusia dhe Serbia janë dy konsumatorët kryesorë të turizmit në Mal të Zi. Pjesëmarrja në eksportin e mallrave, sidomos e metaleve me ngjyra (e aluminit), po pakësohet gjatë viteve të fundit. Kjo është kryesisht për faktin se kompania më e madhe e prodhimit të aluminit, d.m.th. KAP, ka falimentuar, si dhe për shkak të rënies së çmimeve të metaleve me ngjyra. Kjo rënie u kompensua nga rritjet e regjistruara në sektorin e shërbimeve.²⁹

Ndërmarrjet në Malin e Zi kanë kosto të larta për të importuar, gjë që gjithashtu përkthehet në pengesa ndaj

eksportit. Pikërisht, një ndërmarrjeje malazeze, mesatarisht i duhen 33 orë dhe 406 USD, për t'i importuar mallrat e saj.²⁷ Fytet e ngushta (pengesat) në mjedisin e biznesit, duke përfshirë: zgjidhjen e paaftësisë paguese, zbatimin e kontratave, lejet e ndërtimit - për të përmendur disa, përbëjnë disa nga faktorët që e kanë penguar Malin e Zi në rritjen e bazës së vet të eksportit, posaçërisht të eksportit të mallrave.

Bosnja dhe Hercegovina dhe Shqipëria janë dy vendet në vijim të Ballkanit Perëndimor në lidhje me dy treguesit e eksportit. Në të parin, pjesëmarrja e eksporteve në PBB ka qenë rreth 34 përqind dhe eksporti në PBB mesatarisht rreth 1,657 USD; ndërsa në këtë të dytin, 31 përqind dhe 1,212.5 USD. Eksportet e Bosnja dhe Hercegovinës të mallrave dhe të shërbimeve po ashtu kanë përfituar nga kërkesa e jashtme në rritje.

Në përgjithësi, sa u përket dy treguesve, Bosnja dhe Hercegovina ka përjetuar një trend pozitiv të eksporteve. Eksportet e mallrave (të nxitura nga produktet ushqimore, të drurit, ato kimike si dhe pajisjet mekanike) përbëjnë pjesën më të madhe, me një mesatare prej më shumë se 95 përqind. Destinacionet kryesore të eksportit për eksport të mallrave janë BE-ja (mbi 70 përqind) dhe CEFTA (mbi 10 përqind).²⁷ Të dyja, eksporti i mallrave dhe i shërbimeve kanë përfituar nga kërkesa e jashtme në rritje si dhe rritja e pjesëmarrjes në zinxhirët e vlerave të BE-së.

Shqipëria ka përjetuar disa luhate sa u përket eksporteve gjatë viteve të fundit. Çmimet e ulëta të naftës së papërpunuar dhe të tekstileve, që përbëjnë eksportet kryesore të Shqipërisë, kanë ndikuar në zvogëlimin e fitimeve nga eksporti. Nga ana tjetër, shërbimet e forta (kryesisht turizmi), ndihmuan në baraspeshojnë zvogëlimin në eksportet e mallrave. Vlen të përmendet se Shqipëria ka bërë disa përparime sa i përket konsolidimin fiskal dhe disa reforma të tjera strukturore, të cilat në një farë mase i kanë

lehtësuar eksportet.¹⁸ Përkundër të gjitha përpjekjeve, megjithatë, një pjesë e madhe e ndërmarrjeve shqiptare, rreth 87 përqind ende kanë mbetur lokale.²⁷ Sa u përket destinacioneve të eksportit, ngjashëm me Serbinë, Maqedoninë dhe Bosnje dhe Hercegovinën, BE-ja është destinacioni kryesor, e pasuar nga vendet e CEFTA-s.

Kosova zë vendin më të ulët nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor në raport me eksportet. IHD-të, në vend se të jenë burim i madh i rritjes së eksporteve, janë të orientuara kah sektori i shërbimeve, kryesisht pasuritë e patundshme dhe sektori financiar; këta sektorë për nga natyra e tyre nuk mund të kenë rol të drejtpërdrejtë në rritjen e eksporteve. Baza e ulët industriale dhe si rrjedhojë pjesëmarrja e ulët e eksporteve të mallrave e pengojnë integrimin e ndërmarrjeve të Kosovës në rrjetet e biznesit dhe zinxhirët e vlerave globale.

Eksportuesit e Kosovës ballafaqohen me pengesa të natyrave të ndryshme. Një ilustrim tipik është fakti që një firmë të Kosovës i duhet të presë 43 orë për pajtueshmërinë nga kufiri dhe 38 orë të tjera për përputhshmërinë me dokumentacionin. Mesatarja në pesë vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor është 7 orë dhe 3.8 orë. Përveç kësaj, një ndërmarrje nga Kosova duhet të paguajë 264 USD për eksport, krahasuar me një mesatare prej 72 USD në pesë vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.²⁷ Përveç tjerash, qasja e kufizuar në financa, teknologjia e vjetruar, qasja e kufizuar në informatat mbi tregun e eksportit, mungesa e standardeve të cilësisë dhe të menaxhimit, paraqesin disa arsye të tjera që ndikojnë në konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve të Kosovës dhe si të tillë në aftësinë e tyre për të eksportuar.

Nëse merret Ballkani Perëndimor si tërësi, është e qartë se marrëveshja CEFTA-s dhe marrëveshjet e MSA-së (dhe marrëveshjet e mëparshme tregtare me BE-në) i kanë lehtësuar eksportet ndërmjet vendeve të Ballkanit

Perëndimor dhe në BE. Megjithatë, ende duhet të ndërmerren veprimet pakësuese për t'i reduktuar barrierat jo-tarifore që janë shumë të pranishme. Duhet theksuar se këto marrëveshje nuk e trajtojnë qasjen në treg të tregtisë në shërbime, në këtë mënyrë paraqesin pengesë për kompanitë e shërbimit.

Në përgjithësi, ekonomia e ngadalshme globale mund t'i ndërlikojë përpjekjet për rritjen e eksportit. Nga ana tjetër, kjo mund të krijojë edhe mundësi për vendet e Ballkanit Perëndimor, për shkak se firmat ndërkombëtare që kanë tregje, teknologji, dhe kapital do të jenë të gatshme që të zhvendosen për ta përmirësuar konkurrueshmërinë e tyre.

Konkluzione dhe rekomandime

Me këtë analizë të politikave kërkohet të shqyrtohen modelet e investimeve të huaja direkte dhe eksportet në Kosovë në veçanti dhe në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi, si dhe të nxirren rekomandime për Kosovën.

Në përgjithësi, Kosova karakterizohet nga flukse relativisht të ulëta të IHD-ve. Paqëndrueshmëria politike, regjimi jokonkurrues në aspektin e stimujve, madhësia e vogël e tregut vendor dhe klima e pafavorshme e biznesit mund të jenë disa nga arsyet për këtë (mungesë të) performancës. Turqia, Zvicra dhe Gjermania janë vendet kryesore të burimit sa u përket IHD-ve gjatë viteve të fundit. Dominimi i Turqisë lidhet kryesisht me privatizimin e distribucionit të furnizimit me energji elektrike dhe investime në terminalin e ri të aeroportit. Tradicionalisht, dy vendet e tjera kanë qenë në krye sa u përket IHD-ve duke pasur parasysh përqendrimin e diasporës së Kosovës. Sektori i patundshmërive dhe shërbimet financiare, nga ana tjetër, paraqesin dy sektorët që kanë absorbuar pjesën më të madhe të fluksit të IHD-ve gjatë viteve të fundit. Megjithatë, të dy ata sektorë kanë shënuar rënie në vitin 2016, që mund të tregojë se tregu është duke u ngopur.

Nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, Serbia duket të jetë vendi me fluks më të qëndrueshëm të IHD-ve. Perspektivat e BE-së, investimet në zonat e veçanta ekonomike (ZVE), stimujt të konsiderueshme që lidhen me punën, subvencionet financiare, tregu i madh vendor, afërsia gjeografike, procedurat e efektshme, janë disa nga faktorët që ka luajtur rol në tërheqjen e IHD-ve në këtë vend. Shqipëria, me reformat fiskale dhe strukturore të kohëve të fundit; dhe Maqedonia, me një gamë të gjerë të stimujve tatimorë- dhe jo-tatimorë, në këtë drejtim kanë shënuar njëfarë progresi kohëve të fundit.

Sa i përket treguesve të eksportit, Kosova është duke ngecur

prapa vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor. Çështje të pajtueshmërisë kufitare, qasja e kufizuar në financa, teknologjia e vjetruar, qasja e kufizuar në informatat e tregut të eksportit, mungesa e standardeve të cilësisë dhe të menaxhimit, investimet jo adekuate të diasporës - për të përmendur disa, mund të jenë disa nga arsyet që i pengojnë eksportet e Kosovës. Për dallim nga shumica e Ballkanit Perëndimor (përveç Malit të Zi), tregtia në shërbime përbëjnë pjesën më të madhe të totalit të eksporteve. Sa i përket eksportit të mallrave, metalet përbëjnë pjesëmarrjen më të madhe. Mallrat kryesisht u shiten në vendeve të CEFTA-s dhe BE-së.

Nga perspektiva Ballkanit Perëndimor, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi kanë qenë eksportuesit më të mëdhenj gjatë viteve të fundit. Nxitësit kryesorë të eksporteve në Serbi dhe Maqedoni kanë qenë flukset e IHD-ve në sektorin e prodhimit, veçanërisht në industrinë e automobilave; ndërsa investimet në Mal të Zi në turizëm.

Në mënyrë që Kosova të paktën konvergojë me mesataren e vendeve të Ballkanit Perëndimor sa u përket investimeve të huaja direkte dhe eksporteve, rekomandimet e mëposhtme duhet të merren në konsideratë.

Rekomandimet që lidhen me IHD-të

- **Forcimi i regjimit stimulues**– Qeveria e Kosovës duhet të hartojë një paketë konkurruese të stimujve për investitorët potencialë ndërkombëtarë, ku të parashohë ofrimin e mbështetjes financiare (subvencione që lidhen me punën) për ata investitorë, të cilët janë të interesuar të investojnë në sektorët në të cilat Kosova ka përparësi krahasuese.
- **Projektimi/ideimi i stimujve për tërheqjen e investitorëve në sektorin e prodhimitarisë** - Qeveria e Kosovës duhet të hartojë një paketë tërheqëse për investimet në sektorin e prodhimit, sidomos për

degët e prodhuesve të mëdhenj ndërkombëtarë të automobilave. Kjo, ndër të tjera, do të kontribuojë në përmirësimin e përbërjes strukturore të eksporteve drejt produkteve me vlerë të lartë të shtuar. Industria e automobilave ka qenë një nga shtytësit kryesor të flukseve të IHD-ve në Evropën Qendrore, gjatë periudhës së transicionit.

- **Përmirësimi i klimës së biznesit** - Qeveria e Kosovës duhet të intensifikojë përpjekjet e saj për krijimin e një klime të favorshme biznesi, duke forcuar sundimin e ligjit (zbatimin e kontratave), luftën kundër korrupsionit dhe informalitetit, racionalizimin e procedurave tatimore, si dhe duke aplikuar reformat e komasacionit të tokës.
- **Stimulimi i diasporës së Kosovës për të investuar në sektorë të orientuara kah eksporti** - Qeveria e Kosovës mund të iniciojë krijimin e shoqatave të efektshme të biznesit në vendet ku është përqendruar pjesa më e madhe e diasporës kosovare, domethënë në Zvicër dhe Gjermani. Këto, ndër të tjera, do t'i ndihmonte investitorët potencialë nga diaspora përmes krijimit të mundësive për bashkimin dhe rritjen e kapitalit investues si dhe përmes ofrimit të më shumë informatave mbi sektorët me potencial për rritje të eksportit.
- **Ruajtja e stabilitetit politik** - Me kusht që stabiliteti politik është një nga përcaktuesit kryesorë në tërheqjen e IHD-ve, deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet të shmangin sjelljet destruktive dhe anti-institucionale që ndikojnë negativisht në imazhin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Sa më të mirë të jenë lajmet për Kosovën në titujt e gazetave ndërkombëtare, aq më të mëdha janë gjasat që të paktën të kapet interesimi i investitorëve të huaj.

Rekomandimet që lidhen me eksportin

- **Sigurimi i më shumë informatave mbi tregjet rajonale dhe botërore të eksportit** - KIESA dhe aktorët të tjerë të interesuar (p.sh. shoqatat e biznesit) duhet t'i ndihmojnë eksportuesit potencialë të Kosovës duke u ofruar informata të përditësuara mbi tregjet e eksportit, trendet, konkurrencës, e të ngjashme. Informatat e siguruar do t'u ndihmonin eksportuesve potencialë në hartimin e strategjive dhe planeve të tyre relevante të biznesit.
- **Intensifikimi i përpjekjeve për zbatimin e MSA-së** - Qeveria e Kosovës duhet të intensifikojë përpjekjet e saj për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja. Zbatimi i standardeve dhe i kushteve të parapara nga MSA-ja do të rriste kapacitetin e vendit për të eksportuar dhe në përgjithësi do t'i lehtësonte shkëmbimet e produkteve. Ky është një faktor kyç për tërheqjen e më shumë IHD-ve.
- **Mbështetja e pjesëmarrjes në zinxhirët e vlerave evropiane** - KIESA duhet të lehtësojë pjesëmarrjen e eksportuesve në zinxhirët e vlerave evropiane përmes dërgimit të grupeve të ndryshme të kompanive nëpër panairë. Bashkëpunimi eventual me kompani ndërkombëtare do të ndihmonte në krijimin e kanaleve të eksportit.
- **Marrja parasysh e krijimit të grupimeve** - Qeveria e Kosovës duhet të mbështesë krijimin e grupimeve për sektorët konkurrues në Kosovë, duke tubuar dhe duke e lehtësuar ndërveprimin ndërmjet institucioneve arsimore përkatëse, me qendrat kërkimore, dhe ndërmarrjet e orientuara kah eksporti. Nëse është e nevojshme, ajo mund të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet grupimeve dhe internalizimin e këtyre

grupimeve. Këto grupime do të nxisin shkëmbimin e njohurive, nxitjen e sipërmarrjes, hulumtimin dhe inovacionin, si dhe shkëmbimin e praktikave të mira.

- **Të sigurohet zbatimi i plotë i marrëveshjeve të tregtisë** - Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që eksportet drejt anëtareve të CEFTA-s dhe vendet e tjera, me të cilat Kosova ka marrëveshje të tregtisë, nuk ndalohen përmes vendosjes së qëllimshme të barrierave jo-tarifore. Në rastet e shkeljeve të marrëveshjeve të tilla, të cilat pjesën më të madhe të kohës ndodhin në CEFTA, Qeveria e Kosovës duhet të reagojnë qoftë duke ndërmarrë masat e reciprocitetit ose përmes mekanizmave të tjerë që çojnë në heqjen e menjëhershme të këtyre barrierave.
- **Arritja e marrëveshjeve për tregti në shërbime** - Marrëveshjet për tregti në shërbime duhet të arrihen me anëtarët e CEFTA-s dhe të BE-së për të kapërcyer barrierat tregtare të kompanive të shërbimit.
- **Promovimi i certifikimit të produktit** - Qeveria e Kosovës duhet të intensifikojë mbështetjen për firmat e Kosovës kur bëhet fjalë për certifikimin e produktit në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Ky është një parakusht për firmat e Kosovës që të kenë qasje në tregjet e zhvilluara ndërkombëtare.
- **Forcimi i politikave të konkurrencës** - Qeveria e Kosovës duhet të hartojë/zhvillojë politika që nxisin konkurrencën. Zhvillimi/hartimi dhe zbatimi i politikave të konkurrencës do të kishte një ndikim në zbutjen e interesave vetjake si dhe në lehtësimin e hapjen e tregjeve për tregti. Konkurrenca më e ndershme u ndihmon eksportuesve potencialë për të rritur produktivitetin dhe efikasitetin e tyre, si dhe inovacionin dhe aftësinë e tyre për të eksportuar si rezultat i kësaj.

Lista e publikimeve

Zgjedhjet & Partitë Politike

- #1 Instituti D4D. Shtator 2011 Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-2010.
- #2 Instituti D4D. Mars 2012. Reformë sa për adet: Si të rikthejmë besimin në zgjedhje?
- #3 Malazogu, Leon, Visar Sutaj dhe Drilon Gashi. Nëntor 2012. Auditim i listës së votuesve të Kaçanikut: Mostër për Kosovën
- #4 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shkurt 2013. Mësimet e nxjerra për zgjedhjet e ardhshme – Analizë e zgjedhjeve për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik?
- #5 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Interpretimi i besimit – Përceptimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes.
- #6 Malazogu, Leon dhe Selatin Kllokoqi. Shtator 2013. Deforma zgjedhore – Dy vite pas, reforma në pikën zero
- #7 Leon Malazogu dhe Brenna Gautam; Me kontribut nga Rezarta Delibashzade dhe Ngadhujim Halilaj. 26 nëntor 2014. Busolla ideologjike e Kosovës – Hartë e orientimit të partive politike
- #8 Dardan Berisha me kontributin e Driton Qeriqi, Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Rina Vokshi, korrik 2015. Vendosja e drejtësisë në zgjedhje
- #9 Leon Malazogu me kontributin e Ngadhujim Halilaj dhe Rezarta Delibashzade, korrik 2015 Trendet zgjedhore 2000-2014-Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit
- #10 Thomas Atherton, Driton Qeriqi dhe Rina Vokshi,

Shkurt 2016 Doracak për barazi gjinore në procesin zgjedhor

Rekomandimet e Forumit Reforma

- #1 Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Struktura e KQZ-së
- #2 Hartuar nga Instituti D4D. 17 janar 2011. Sistemi zgjedhor
- #3 Hartuar nga Instituti D4D. 29 nëntor 2011. Riparimi i listës së votuesve
- #5 Hartuar nga Instituti D4D. 12 dhjetor 2011. Rekomandimet për Zgjedhjen e Presidentit të Kosovës
- #6 Mbështetur nga: D4D, KIPRED, INPO, KMDLNJ, INDEP, DT, KHK, QPA, dhe NOMP. Për reformë të mirëfilltë zgjedhore

Marrëdhëniet ndëretnike

- #1 Malazogu, Leon dhe Vladimir Todorić. Nëntor 2011. Dialogu Beograd – Prishtinë: Nevojitet transformim i interesit vetanak. PER-K/D4D Institute and NPC-Belgrade
- #2&3 Malazogu, Leon, Viktor Popović dhe Shpend Emini. Mars 2012. Perspektiva e një të riu serb në Kosovë/Jeta urbane në vendbanime me shumicë serbe në Kosovë. PER-K/D4D.
- #4 Malazogu, Leon dhe Florian Bieber. Raportet në mes të Beogradit dhe Prishtinës në të ardhmen. PER-K/Instituti D4D
- #5 Malazogu, Leon dhe Alex Grigorev. Shtator 2012. Nga paqartësia kreative në proces konstruktiv – Si ti qasemi veriut të Kosovës? PER-K/Instituti D4D
- #6 Ejodus, Filip, Leon Malazogu dhe Milan Nic. Tetor 2013. Zgjedhjet komunale në veri të Kosovës: Drejt

një ekuilibri të ri? Publikuar bashku CEPI, BCSP dhe D4D. (Vetëm në gjuhën angleze)

- #7 Mjellma Hapçiu-Alijaj dhe Ajete Kërçeli. Me kontribut nga: Shpend Emini, Rezarta Delibashzade dhe Ferid Murseli. Tetor 2016. Gratë e fuqizuara: çelës për transformimin e komuniteteve

Interesi Publik

- #1 Sejdiu, Dardan dhe Kastriot Jahaj. Janar 2013. ‘Taksa’ e fshehur: pse kosovarët paguajnë më shumë?
- #2 Gashi, Drilon and Shoghi Emerson. Maj 2013. Klasë në vete: Patronazhi dhe ndikimi i tij në mobilitetin shoqëror në Kosovë
- #3 Sutaj, Visar and Leon Malazogu. Janar 2013. Roli i shoqatave me anëtarësi në formësimin e vendimmarrjes në shërbim të interesit publik
- #4 Miftari, Naser. Shtator 2013. Sfida e konsolidimit – Fuqizimi i pavarësisë së institucioneve të medias në Kosovë
- #5 Ardiana Gashi dhe Artane Rizvanolli; Me kontribut nga Natalya Wallin, Rezarta Delibashzade dhe Ngadhnjim Halilaj. 25 shkurt 2015. Sa kushton patriarkati?
- #6 Rezarta Delibashzade, Laura Flemming, Ramadan Klisurica, Agon Maliqi dhe Rina Abazi. 11 Nëntor 2015 Rëndësia e grupeve të interesit: Praktikat, rastet studimore dhe mësimet e nxjerra
- #7 Dukagjin Pupovci dhe Gersi Gashi. Nëntor, 2015 Reformimi i Universiteti të Prishtinës – mision i mundur?
- #8 Leon Malzogu dhe Bernard Nikaj; Me kontribut nga

- Gulliver Brady. Nëntor, 2016. Nxitje për llogaridhënie dhe performancë më të mirë në arsimin e lartë
- #9 Jehona Serhati, me kontribut redaktues nga Abby Riley. Janar, 2017. Stimujt për reformë: Rritja e mundësive për nxënësit/et dhe të diplomuarit/at e AAP-së në tregun e punës
- #10 Isuf Zejna. Korrik 2017. Zhvillimi i turizmit përmes politikave dhe legjislacionit efikas.
- #11 Visar Sutaj. Tetor 2017. Sa të pavarura janë autoritetet rregullatore në Kosovë?
- #12 Linda Abazi Morina dhe Rezarta Delibashzade. Me contribute nga Ajete Kërçeli dhe Valëza Zogiani. Nëntor 2017. Joaktiviteti i grave në tregun e punës.
- #13 Ajete Kërçeli. Me contribute nga Ardiana Gashi. Dhjetor 2017. Ndryshimi i paradigmes – Barazi përmes lejes prindërore.

Memorandume Reaguese

- #1 Instituti D4D. Nëntor 2012. Memorandumi reagues Nr. 1 – Reagimi i tepruar i policisë
- #2 Instituti D4D. Dhjetor 2012. Memorandumi reagues Nr. 2 – Modeli i dy Gjermanive
- #3 Instituti D4D. 12 Korrik 2013. Memorandumi reagues Nr. 3 – Kriteria të qarta për komuna të reja
- #4 Instituti D4D & Qëndrim Gashi. Janar 2013. Memorandum reagues nr. 4 – Universiteti i Prishtinës në rreth vicioz
- #5 Instituti D4D dhe Kushtrim Palushi. Janar 2013. Memorandum reagues nr. 5 – Reforma zgjedhore
- #6 Instituti D4D. Nëntor 2016. Memorandum reagues nr.6 – Reforma zgjedhore

Indikatorët & skenaret

- #1 Instituti D4D. Nëntor 2010. Para dhe Pas-Performanca e bazuar në indikatorë: Vlerësimi vjetor 2010
- #2 Instituti D4D. Shteti në Pasqyrë: Indikatorët e Bazuar në Performancë
- #3 Malazogu, Leon. Nëntor 2013. As për emër nuk janë pajtuar: Shtyrja e problemit nuk do të afrojë palët në lidhje me asociacionin/bashkësinë. (Vetëm në gjuhën angleze)
- #4 Malazogu, Leon. Janar 2014. Parashikime dhe skenare: Kosova dhe Bota në 2014

Publikime të tjera

- #1 Seritë e editorialeve dhe rekomandimeve mund gjithashtu të gjinden në ueb-faqen tone.

Endnote

- ¹ Estrin S., Hanousek J., Kocenda E., and Svejnar J. (2009), The Effects of Privatisation and Ownership in Transition Economies. *Journal of Economic Literature*, 47 (3): 699–728
- ² Borenzstein, E., De Gregorio, J., Lee, J-W. (1998), How does foreign direct investment affect economic growth? *Journal of International Economics* 45 (1998) 115–135.
- ³ Caves, R. E. (1996), *Multinational Enterprise and Economic Analysis*. Cambridge: Cambridge University Press.
- ⁴ Siliverstovs, B., Herzer, D. (2007) Manufacturing exports, mining exports, and growth: cointegration and causality analysis for Chile (1960-2001). *Appl Econ* 39: 153- 167.
- ⁵ Helpman, E., Krugman, P. (1985), *Market structure and foreign trade*. MIT Press, Cambridge, Mass.
- ⁶ Grossman GM, Helpman E (1991), *Innovation and growth in the global economy*. MIT Press, Cambridge, Mass.
- ⁷ Feder, G. (1983), On exports and economic growth. *J Development Econ* 12: 59-73.
- ⁸ Chuang Y-C (1998), Learning by doing, the technology gap, and growth. *Int Econ Rev* 39: 697-721.
- ⁹ Keho. Y. (2015), Foreign Direct Investment, Exports and Economic Growth: Some African Evidence. *Journal of Applied Economics and Business Research JAEBR*, 5(4): 209-219
- ¹⁰ Banka Qendrore e Kosovës (2017), *Fluksi i IHD-ve*. [Dosja e të dhënave]

- ¹¹ IOM-it dhe UNDP-i (2013), *Lehtësimi i investimeve nga diaspora në Kosovë: Vlerësimi dhe planifikimi i strategjive të reja në nivel lokal dhe qendror*

¹²Banka Qendrore e Kosovës (2016), Raporti i Stabilitetit Financiar

¹³Agjencia e Statistikave (2017), Tregtia e Jashtme. [Dosja e të dhënave]

¹⁴Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (2017), Raporti mbi Tregtinë në Shërbime - Bilanci i Tregtisë 2016.

¹⁵Banka Botërore (2017), Fluksi i IHD-ve [Dosja e të dhënave]

¹⁶Gazsjellësi Trans-Adriatik. Ndërtimi i tubacionit në Shqipëri.

¹⁷OECD (2017), Tracking Special Economic Zones in the Western Balkans: Objectives, Features and Key Challenges.

¹⁸World Bank (2017), Western Balkans Regular Economic Report No.11. Faster Growth, More Jobs.

¹⁹World Bank (2017) Total Population [Data file]

²⁰World Bank (2017). GDP in Current USD. [Data file]

²¹World Bank (2017), FDI net inflows (% of GDP) [Data file]

²²World Bank (2017). Doing Business 2017: Kosovo.

²³Republika e Kosovës (2017). Ligji mbi investimet strategjike.

²⁴U.S. Department of State (2017). Bosnia and Herzegovina. Investment Climate Statement 2017.

²⁵World Bank (2017) Exports of goods and services (BoP, current USD).

²⁶World Bank (2017) Exports of goods and services (% of GDP).

²⁷US Embassy (2017) Serbia – Market Overview.

²⁸World Bank (2017) WESTERN BALKANS: Regional Economic Integration Issues Notes.

²⁹IMF (2016) Montenegro Selected Issues. IMF Country Report No. 16/80

“This grant is financed by the project Democratic Society Promotion (DSP) – financed by the Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) and the Ministry of Foreign Affairs of Denmark (DANIDA) and managed by the Kosovo Civil Society Foundation (KCSF)”



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

Xxxx

ISBN Xxxx

The Democracy for Development (D4D) Institute was established in April 2010 by a group of analysts who were increasingly worried that the state-building exercise had neglected democracy. D4D's mission is to influence the development of public policy in order to accelerate socio-economic development, improve governance, and strengthen democratic culture in Kosovo.

D4D's vision is to promote an active and educated citizenry that both fully participates in the public space and utilises the public arena of representation and decision-making to deliberate and build consensus over smart, efficient, and sustainable resource allocation as well as equitable development.

For more information about D4D's activities please visit our website: www.d4d-ks.org.

